



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI RREGULLATOR

Data: 15 Shkurt 2022

Nr: 18

V E N D I M

P Ë R

**RREGULLAT PROCEDURALE PËR PROCESIN E VOTIMIT DHE NUMËRIMIT
ELEKTRONIK NËPËRMJET PAJISJES ELEKTRONIKE TË VOTIMIT DHE
NUMËRIMIT (PEVN) NË QENDRAT E VOTIMIT TË BASHKISË VORË, QARKU
TIRANË, PËR ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR BASHKIE TË DATËS 6
MARS 2022**

Në mbështetje të Dekretit nr. 13438, datë 20.01.2022, të Presidentit, “Për caktimin e datës së zgjedhjeve të pjesshme vendore për kryetar bashkie, për disa njësi të qeverisjes vendore”, të nenit 20, pika 1, shkronja “e”, pika 2, shkronja “c”, neni 22, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator

V E N D O S I:

1. Në zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie, të datës 6 Mars 2022, do të zbatohet projekti pilot për procesin e votimit dhe numërimit elektronik të votave nëpërmjet pajisjeve elektronike të votimit dhe numërimit (PEVN), të përdorura në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021, në të gjithë qendrat e votimit në bashkinë Vorë, qarku Tiranë.
2. Si rregull, në çdo qendër votimi, duhet të ketë të paktën 2 (dy) pajisje elektronike të votimit dhe numërimit. Përgjithësisht, për zgjedhjet e pjesshme të datës 6 Mars 2022, çdo qendër votimi (QV) në bashkinë Vorë të ketë 1 (një) pajisje elektronike të votimit dhe numërimit (PEVN).
3. Komisioni i Qendrës së Votimit (KQV), për procedurat të cilat nuk janë të automatizuara, zbaton rregullat e përcaktuara në vendimin nr. 11, datë 25.03.2021, të Komisionit Rregullator, “Për mënyrën e ngritjes, organizimit dhe funksionimit të Komisionit të Qendrës së Votimit dhe

zhvillimit të zgjedhjeve në Qendrën e Votimit”, ndërsa për procedurat e votimit dhe numërimit elektronik vepron në përputhje me aktet e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

4. KQZ-ja i dorëzon KZAZ-së:
 - a) Materialet zgjedhore të përcaktuara në nenin 18 të vendimit nr. 11, datë 25.03.2021, të Komisionit Rregullator, “Për mënyrën e ngritjes, organizimit, funksionimit të Komisionit të Qendrës së Votimit dhe zhvillimit të zgjedhjeve në Qendrën e Votimit”, i ndryshuar;
 - b) PEVN-të me kutitë shoqëruese që mundësojnë votimin elektronik.
5. KZAZ-ja i dorëzon KQV-së materialet zgjedhore dhe PEVN-të me kutitë shoqëruese që mundësojnë votimin elektronik si dhe procesverbalet dhe dokumentacionin e punës të përshtatur për këtë bashki.
6. Në rastet kur votimi elektronik për arsye teknike që lidhen me pajisjen e votimit, nuk mund të fillojë, apo pasi ka filluar është ndërprerë dhe nuk mund të vijojë, ngarkohet Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve të vendosë mbi vijimin e procedurës së votimit me fletë votimi.
7. Zgjedhësi, që për arsye fizike nuk është në gjendje të kryejë vetë procedurat e votimit, mund të kërkojë ndihmën e një familjari ose zgjedhësi tjetër, që është në listën e zgjedhësve të asaj zone të qendrës së votimit. Të dy zgjedhësit duhet të jenë të pranishëm në qendrën e votimit kur përdoret kjo procedurë. Një person mund të ndihmojë vetëm një zgjedhës që nuk mund të votojë vetë.
8. Personeli teknik i ngarkuar nga KQZ-ja për përdorimin e PEVN-së, në përfundim të votimit kryen mbylljen e procesit në pajisjen elektronike të votimit e numërimit, skanon nga sistemi rezultatin e zgjedhjeve për atë QV dhe e dërgon elektronikisht në aplikacionin e ngritur posacërisht nga KQZ-ja.
9. Rezulati paraprak nxirret dhe publikohet pasi është dërguar në KQZ rezultati i votimit për çdo qendër votimi të bashkisë Vorë.
10. Procesi i nxjerrjes së rezultateve për çdo QV dhe në rang bashkie realizohet nga KZAZ-ja në ambientin e VNV-së përcaktuar nga KQZ.
11. Pas mbylljes së votimit, KQV-të dorëzojnë pranë VNV-së pajisjet PEVN, së bashku me materiale të tjera zgjedhore.
12. Pas dorëzimit nga të gjitha KQV-të pranë KZAZ-së të pajisjeve dhe materialeve përkatëse, KZAZ-ja, në prani të vëzhguesve, kryen procesin e numërimit të votave në Sistemin Elektronik të

Menaxhimit të Votimit dhe Rezultateve (SEMVR), sipas procedurave teknike dhe operacionale të përcaktuara me akt të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

13. SEMVR do të kryejë përlogaritjen e rezultatit dhe do të shfaqë në monitor e do të printojë në letër tabelat e rezultateve për çdo QV si dhe Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve për bashkinë Vorë sipas modeleve të miratuara nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.
14. Tabelat e rezultateve, si për QV-në dhe për bashkinë, firmosen nga anëtarët e KZAZ-së. Tabela Përmbledhëse e Rezultateve miratohet me vendim nga KZAZ-ja.
15. Në rastin kur procedura e votimit është zhvilluar në njërin pjesë të ditës elektronikisht dhe në një pjesë tjetër të ditës manualisht, KZAZ aktivizon GNV-të të ndjekin procedurat standarde për hapjen e kutive të votimit, numërimin, vlerësimin dhe nxjerrjen e rezultateve sipas udhëzimeve të KQZ-së vetëm pasi sistemi ka gjeneruar raportin me rezultatet e votimit për pjesën elektronike.
16. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve kujdeset për informimin e zgjedhësve dhe të administratës zgjedhore në lidhje me përdorimin e PEVN-së.
17. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
18. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative së Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Ilirjana NANO - Kryetare

Arens ÇELA - Anëtar

Dritan ÇAKA - Anëtar

Helga VUKAJ - Anëtare

Muharrem ÇAKAJ - Anëtar

